

THIRRJE

Për shprehje të interesit për monitorim - vëzhgim të Zgjedhjeve Studentore të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), 2026.

- I. Bazuar në Rregulloren për Zgjedhjet Studentore, UShAF u bënë thirrje të gjitha institucioneve, organizatave dhe palëve të tjera për shprehje të interesit për monitorim të gjithë procesit të Zgjedhjeve Studentore të shpallura me datën 28.05.2026, të cilat do të mbahen me datën 16.06.2026.
- II. Shprehja e interesit për monitorim të zgjedhjeve nga institucionet, organizatat dhe palët e tjera, bëhet në formë të shkruar dhe dorëzohet në Zyren 008 të UShAF. Aplikimi për monitorim duhet të përmbajë: emrin e institucionit; Dëshmi se është person juridik; Emrin dhe mbiemrin e personit të autorizuar për monitorim; Numrin kontaktues dhe e-mail adresën.

Aplikimi për monitorim - vëzhgim të Zgjedhjeve Studentore dhe certifikimi bëhet me datë 08.06.2026, prej orës 8 deri 15:00.

UShAF është i përkushtuar për një proces të rregullt zgjedhor, transparent dhe korrekt.

Ju mirëpresim!

Kryesuesi i KQZ-së
Armend Hysa

